

URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën
vëzhgim të përhershëm

09 prill 2016, Prizren

Reagim#30

REAGIM

Monumenti që po cenohet nga zjarri të hyjë nën kontrollin e institucionit kompetent

Ndërtesa, që është aset i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme të MKRS-së, si pjesë e Kompleksit të Kishës Katolike, Zonja Ndhimtare, të premtën mbrëma është përfshirë përsëri nga zjarri në rrethana ende të pasqaruara nga organet e emergjencave dhe të sigurisë, që paraqet rastin e dytë të kësaj natyre brenda tre javësh në këtë monument.

Ky rast, sikurse edhe i mëparshmi, kërkon hetim të menjëhershëm dhe të hollësishëm nga organet e hetuesisë, pasi që ditë më parë edhe zyrtarët e Drejtorisë së Emergjencave të Komunës së Prizrenit, në paraqitjet e tyre mediale kishin ngritur dyshime se zjarri është shkaktuar nga faktori njeri.

EC Ma Ndryshe javë më parë pat apeluar te institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin veprime konkrete për të parandaluar përsëritjen e skenarëve të tillë.

Neni 13 i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit që përkufizon Masat e mbrojtjes ndaj zjarrit apo fatkeqësive natyrore në paragrafin e parë obligon Komunën e Prizrenit që të hartojë planin për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit kundër zjarrit, rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni thekson se “Çdo lokacion, monument kulturor në pronë private apo publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës, në pajtim me ligjet në fuqi si dhe me doracakun e masave mbrojtëse ndaj fatkeqësive natyrore dhe të zjarrit”. Në bazë të vëzhgimit të zhvillimeve rreth ndërtesës që është pjesë e Kompleksit të Kishës Katolike, gjatë javëve të fundit, nuk është vërejtur asnjë masë mbrojtëse kundër zjarrit në këtë lokacion, ani pse ai njëherë ishte kapluar nga flakët. Kësisoj monumenti i trashëgimisë kulturore ishte lënë në mëshirë të piromanëve.

Në të njëjtën kohë dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore parashohin që monumentet e mbrojtura të kalojnë në pronësi të institucionit kompetent nëse ka veprime të pamjaftueshme nga shfrytëzuesi për të mbrojtur kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. “Trashëgimia kulturore e mbrojtur mund të kalojë dhe vendoset në të drejta pronësore nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent në pajtim me legjislacionin relevant ku ka rrezik të identifikuar të dëmtimit të qëllimshëm ose shkatërrimit të trashëgimisë kulturore ose ku është ndërmarrë veprim i pamjaftueshëm nga pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi për të mbrojtur kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore”, shkruan në nenin 4.22 të LTK-së.

Duke i marrë për bazë ndodhitë e fundit në këtë monument të mbrojtur EC Ma Ndryshe kërkon nga organet e hetuesisë që ta zbardhin rastin në tërësi dhe që kryesit eventuale t'i vënë para organeve të drejtësisë.

Në të njëjtën kohë i bënë thirrje autoriteteve shtetërore që për këtë monument në përputhje me dispozitat e LTK-së të iniciojnë kalimin dhe vendosjen në të drejta pronësore nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent meqenëse shfrytëzuesi aktual ka ndërmarrë veprime të pamjaftueshme për ta mbrojtur atë.

Dhe në fund, EC Ma Ndryshe kërkon që Ministria e Kulturës të ndërmarrë intervenime emergjente në këtë ndërtesë, përkatësisht ta restaurojë atë në tërësi.

Me nderime,

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &

Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

përkrahet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur